



Rockefeller  
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

---

# Fakte mbi #AktivitetinFilantropik 2019

| Përgatiti: **Maris Selamaj** dhe **Ana Zenelaj**

---

## Vështrim i përgjithshëm

Viti **2019** ka qenë një vit i vështirë dhe i pazakontë. Situata që pasoi tërmetin e 26 nëntorit ishte e paprecedent dhe solli një tranzicion në kulturën e dhurimit, humanizmit dhe solidaritetit ndërmjet shqiptarëve.

Përmes një monitorimi të kujdesshëm ditor të dhurimeve, fushatave dhe eventeve të botuara në media të ndryshme, media sociale, faqet e internetit të institucioneve publike dhe jopublike gjatë vitit 2019, u vërejt një mobilizim masiv që regjistroi një shumë dhurimesh mbresëlënëse prej **1,556,350,829 Lekë (12,537,766 Euro)**, nga të cilat 1,349,566,398 Lekë (10,876,877 Euro) ishin një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj tërmetit të nëntorit. Vlen të përmendet gjithashtu se pati një koordinim mjaft të suksesshëm midis aktorëve të ndryshëm si pushteti vendor dhe qendror, organizatat jofitimprurëse, individë, biznese dhe institucione të tjera.

*Ky raportu bë i mundur me falë mbështetjes së Rockefeller Brothers Fund. Opinionet dhe pikëpamjet e autorëve nuk tregojnë ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondit.*

*Të gjitha të drejtat e rezervuara © Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim*

# Parathënie

Prej vitit 2011 Partnerët Shqipëri punon për promovimin e filantropisë në vend . Duke marrë në konsideratë informacionet e pakta në këtë fushë, **Partnerët Shqipëri** kreu studimet:

- “**Sipërmarrja dhe Filantropia**” për të krijuar një kuptim më të qartë të shkallës dhe natyrës së kauzave shoqërore të cilat mbështeten prej komunitetit të biznesit në Shqipëri,
- “**Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri**”, që trajton këtë veprimtari, figurat kryesore dhe aktivitetin e tyre filantropik brenda dhe jashtë vendit, nga shekulli i XIX e deri në ditët e sotme,
- “**Aktiviteti Filantropik i Ndërmarrjeve në Shqipëri, Studimi i Dytë, 2016**” i cili synon të vlerësojë nivelin dhe karakteristikat e aktivitetit filantropik që kryen sektori i biznesit në Shqipëri, tiparet e zhvillimit të këtij aktiviteti gjatë periudhës 2011-2016, si dhe tendencat për të ardhmen.

Për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e kësaj traditë të hershme dhe me vlera, Partnerët Shqipëri organizon tashmë prej gjashtë vitesh ceremoninë “**Cmimi i Filantropisë**”, duke shprehur mirënjohjen dhe falenderimin për individët, familjet dhe bizneset që kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës në vend. Vlerësimi dhe stimulimi i një aktiviteti të tillë mbetet i rëndësishëm për dimensionin human dhe ekonomik që ai mbart.

Sektori i biznesit luan, midis aktorëve të tjerë, një rol të rëndësishëm në mbështetjen e iniciativave që adresojnë probleme të mprehta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Në këtë funksion, Partnerët Shqipëri ka vendosur një partneritet të ngushtë me sektorin e biznesit në mbështetje të bizneseve të reja sociale në fushën e industrisë së gjelbërt.

Prej vitit 2012 Partnerët Shqipëri organizon “**Konkursin e Bizneseve të Gjelbra**”, i cili ofron mbështetje për start-upet, iniciativa të reja të gjelbra që përdorin burime lokale dhe rivitalizimin e traditave të prodhimit dhe tregjeve lokale. Financimi mbështetës është një kombinim i institucioneve filantropike dhe kontributeve nga biznesi. Tre idetë më të mira fituese konkurojnë në nivel rajonal në "**Konkursin Ballkanik të Bizneseve të Gjelbërta**" që organizohet nga Balkan Green Foundation.

# Metodologjia

Ky raport pasqyron aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2019 i sjellë në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe **raportimin e rregullt mujor**. Metodologjia e përdorur për realizimin e tij u bazua në të dhëna të mbledhura nga hulumtimi ditor i mediave, përfshi ato sociale si dhe nga institucionet publike dhe jo-publike gjatë periudhës **janar - dhjetor 2019**.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve. Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.

# Terminologjia

**OJF** - Organizata Jofitimprurëse

**Publik i Gjerë** - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës

**Zbutja e Varfërisë** - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

**Grup Individësh** - Grupe të mëdha ose të vogla individësh që dhurojnë

**Mix** – Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet


**Dhurime Sezonale** – Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

**TIK** - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

## Numri i Dhurimeve

Në vitin 2019 u identifikuan **499** dhurime të raportuara në total, nga të cilat **136** (27%) ishin në përgjigje të tërmetit të 26 nëntorit.


Për sa i përket natyrës së dhurimeve, **441** (88,4%) ishin në vlerë monetare, **45** (9.0%) në mallra / produkte, **8** (1.6%) në shërbime dhe **5** (1%) në forma të tjera dhurimi.



## Vlera e Dhurimeve sipas Natyrës në Lekë


**1,556,350,829 Lekë** (12,537,766 Euro) është vlera totale e dhurimeve të identikuara në nivel kombëtar për vitin 2019. Këto dhurime u kryen në vlerë monetare, mallra/produkte dhe shërbime. Dhurimi monetar vazhdon të mbetet forma më e preferuar me 99,98% të vëllimit të përgjithshëm të dhurimeve.

Një pjesë e konsiderueshme e kësaj shume, 1,349,566,398 lekë (87%) u grumbullua gjatë periudhës Nëntor - Dhjetor 2019, si rezultat i fushatave dhe eventeve në përgjigje të tërmetit të nëntorit.



## Forma e Dhurimit

■ Dhurim i drejtpërdrejtë (50.3%) ■ Thirrje për dhurim/Fushatë (27.05%)  
■ Event (22.65%)



**Dhurimi i drejtpërdrejtë** vazhdon të jetë forma e preferuar e dhurimit me **251** (50,3%) raste, kryesisht pasojë e impaktit të drejtpërdrejtë që kjo formë ka tek përfituesit përfundimtarë. Sidoqoftë, vlen të përmenden fushatat dhe eventet e organizuara gjatë këtij viti me një numër total prej **135 fushata** (27.05%) dhe **113** (22.65%) **evente**.

Fushatat dhe eventet më të spikatura janë ato që pasuan pas tërmetit të 26 Nëntorit. Media, portalet online, rrjetet sociale dhe platformat e ndryshme luajtën një rol kryesor në ndërgjegjësimin e publikut dhe mbledhjen e ndihmave për ata që u prekën nga kjo tragjedi. Platforma kryesore dhe më gjithëpërfshirëse ishte portali qeveritar **e-Albania**.


Fushata të tjera të suksesshme u realizuan në ditët që pasuan tërmetin përmes platformave crowdfunding si: **GoFundMe**, **JustGiving**, **Giving Balkans**, etj, apo edhe përmes **Facebook**, me një shumë dhurimesh prej afërsisht **754 milion Lekë**, nga rreth **90,000 donatorë të ndryshëm**.\* Dhurimet nga diaspora shqiptare përbëjnë pothuaj 89% të dhurimeve të grumbulluara.

Disa evente të rëndësishme humanitare dhe koncerte bamirësie për njerëzit e prekur nga tërmeti ishin edicioni i vitit 2019 i "**Kënga Magjike**" apo mbrëmja humanitare "**Nesër**" e cila solli së bashku më shumë se 50 artistë nga fusha të ndryshme të artit.

*\*Referuar vetëm vlerës së dhurimit dhe donatorëve të identifikuar përmes platformave crowdfunding.*

## Kanalet e Dhurimit



**OJF-të** ishin kanali kryesor i dhurimit, (33% e totalit të rasteve), 153 (30 %) u kanalizuan përmes **institucioneve sociale**, ndërsa 108 (22%) raste dhurimi shkuan **drejtpërdrejt tek përfituesit përfundimtarë**.



## Shpërndarja e Dhurimeve në Bazë Mujore

Viti 2019, ishte viti me numrin më të lartë të dhurimeve në 5 vitet e monitorimit të aktivitetit filantropik në Shqipëri. Një nga arsyt kryesore për këtë numër mbreslënës i atribuohet dhurimeve që pasuan tërmetin që goditi Shqipërinë më 26 Nëntor 2019. PSH monitoroi **58 fushata crowdfunding** në nëntor, të cilat u krijuan menjëherë pas tërmetit, dhe **78 fushata dhe evente** në dhjetor, duke shënuar muajin me numrin më të lartë të dhurimeve.


Dhjetori ishte gjithashtu muaji me shumën më të lartë të dhurimit të regjistruar me **1,100,626,653 Lekë** (8,868,678 Euro), ndjekur nga nëntori me **251,448,397 Lekë** (2,026,132 Euro) dhe maji me **66,490,742 Lekë** (535,921 Euro).



## Vlera sipas Natyrës së Dhuruesit

Si rezultat i numrit të madh të fushatave dhe eventeve të organizuara për shkak të fatkeqësisë natyrore të nëntorit por jo vetëm, dhuruesit **Miks** renditen të parët me një vlerë totale prej **820,926,335 Lekë** (6,626,620 Euro).


**519,780,730 Lekë** (4,195,735 Euro) ishte dhurimi i kryer nga *Korporatat*, i ndjekur nga *Individualët* me **123,090,709 Lekë** (993,642 Euro), *Grup Individësh* me **75,977,634 Lekë** (613,458 Euro) dhe lloje të tjerë të dhuruesve me një shumë totale prej **16,575,421 Lekë** (133,846 Euro).



## Numri i Dhuruesve\*

Gjatë fushatave apo eventeve për grumbullimin e fondeve për çështje të ndryshme mobilizohen lloje të ndryshme dhuruesish, të cilët kategorizohen në raport si dhurues Miks. **85** rastet e dhuruesve *miks* të identifikuar gjatë vitit 2019 përbëjnë 52.7% të vlerës totale të dhurimeve të identifikuar.


Kategoritë e tjera të dhuruesve që kanë kontribuar më së shumti gjatë 2019 janë *Korporatat* (**70** raste) me 33.4% të vlerës totale, ndjekur nga *Grup Individësh* (**58** raste) me 4.9% të vlerës totale të dhurimeve.



\*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.


# Fushat e Dhurimit

Për sa i përket fushave të dhurimit, situata është paksa e ndryshme nga viti i kaluar. Tre fushat kryesore të dhurimit janë **Mbështetja për Grupet e Margjinalizuara** me **35,5%** të totalit të rasteve të dhurimeve, e ndjekur nga **Fatkeqësia Natyrore** me **27,3%**, dhe **Zbutja e Varfërisë** me **15,2%** të totalit të rasteve.




# Përfituesit


Përfituesit kryesorë për vitin 2019, ishin *Publiku i Gjerë* me **250** (50%) të totalit të rasteve të dhurimit, i ndjekur nga *Fëmijët dhe të Rinjtë* me **185** (37%) dhe *Të Rriturit* me **64** (13%) të totalit të rasteve të dhurimit.




- Zonë Specifike (38.8%)
- Vështirësi Ekonomike (38.8%)
- Publik i Gjerë (21.2%)
- Komunitete Minoritare (0.8%)
- Komuniteti LGBT (0.4%)



- Të moshuar (56.25%)
- Viktima të Dhunës (17.19%)
- Prob.Shëndet.Fizik (12.5%)
- Paaftësi Fizike (4.69%)
- Viktima të Trafikimit (4.69%)
- Prindër të Vetëm (3.13%)
- Të pastrehë (1.56%)



- Pa Përkujdesje Prindërore (58.38%)
- Paaftësi Intelektuale (16.76%)
- Zonë Gjeografike Specifike (10.81%)
- Prob.Shëndet.Fizik (7.57%)
- Paaftësi Fizike (3.24%)
- Të Talentuar (1.08%)
- Vësht.Ekonomike (1.08%)
- Të pastrehë (0.54%)
- Komunitete Minoritare (0.54%)




Këta grafikë paraqesin informacion të detajuar në lidhje me grupet kryesore të përfituesve përfundimtarë.




# Shpërndarja Gjeografike e Dhurimeve

## Përfituesit




## Dhuruesit



Gjatë vitit 2019 pati dhurime nga e gjithë Shqipëria, por **Tirana** u rendit përsëri në vend të parë me **79.4%** të dhurimeve të përgjithshme në nivel kombëtar. **Diaspora** shqiptare luajti gjithashtu një rol të rëndësishëm me **12.8%** të dhurimeve që erdhën si rezultat i fushatave të ndryshme të lançuara nga shqiptarët që jetojnë në **Evropë, SHBA**, etj.

Gjithashtu dhurimet nga komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht në përgjigje të tërmetit të nëntorit nga vende të tilla si: **Hollanda, Skocia, Suedia, SHBA**, etj patën një impakt të konsiderueshëm.



A night street scene in Fushata, Cairo, featuring illuminated buildings and decorative spherical lights hanging from the streetlights. The scene is captured from a low angle, looking down a wide street with multiple lanes. The buildings on the left are lit up, and the streetlights are decorated with large, glowing spherical ornaments. The overall atmosphere is festive and urban.

# Evente & Fushata

## ABI Bank mbështet "Strehëzën për Gra dhe Vajza"

**ABI (Banka Amerikane e Investimeve)**, në kuadër të përgjegjësisë sociale konsideron prioritare barazinë gjinore. Lufta për barazi gjinore dhe veçanërisht dhuna në familje apo dhuna ndaj gruas është një nga problemet më të dhimbshme të shoqërisë sonë. Gjatë vitit 2019, **ABI Bank** mbështeti "Strehëzën për Gra dhe Vajza" në Tiranë. Investimi synonte të përmirësonte mjedisin fizik të Strehëzës, si një mënyrë për të garantuar një cilësi më të mirë shërbimi dhe kushte më të mira jetese. Të gjitha orëditë e vjetra dhe pajisjet sanitare u zëvendësuan me pajisje të reja dhe funksionale. Padyshim që kjo ka qenë një ndihmë e madhe si për personelin që punon pranë Strehëzës, ashtu edhe për gratë apo vajzat (viktima të abuzimit ose trafikimit) që e konsiderojnë strehën një hapësirë të sigurt për to.

## Mendoni për ata që janë të disavantazuar!

**Kryqi i Kuq Shqiptar** organizon çdo tetor **Fushatën Kundër Urisë** në të gjitha degët e saj me shtrirje gati në tërë Shqipërinë. Tetori është muaji zyrtar kundër urisë, kështu që gjatë kësaj kohe çdo vit zhvillohen nisma të ndryshme. Falë kontributit të bizneseve të ndryshme, korporatave dhe institucioneve publike (siç janë shkollat), shumë familje në nevojë ekonomike në qytete të ndryshme të Shqipërisë morën ndihmë dhe mbështetje si rezultat i kësaj fushate kombëtare. Motoja e fushatës ishte solidariteti dhe ofrimi i ndihmës për njerëzit në nevojë, sepse të gjithë meritojnë një jetë dinjitoze.

## Prilli është Muaji i Ndërgjegjësimit për Autizmin

Prilli është Muaji Botëror i Ndërgjegjësimit për Autizmin, kushtuar informimit mbi Çrregullimet e Spektrit të Autizmit (**ASD**). Në këtë muaj, njerëzit në mbarë botën ndërmarrin një përpjekje globale për të ndihmuar në rritjen e të kuptuarit dhe pranimin e individëve me autizëm. Misioni kryesor i **TISS Center** është pikërisht të ndihmojë në informimin se çfarë është autizmi dhe të ofrojë vlerësime psikologjike nga ekipe të kualifikuara multidisiplinare. Një nga aktivitetet më domethënëse që kjo qendër ofroi në kuadër të Muajit të Autizmit, ishin ekzaminimet mjekësore dhe diagnostifikimet pa pagesë gjatë gjithë muajit për të gjithë fëmijët.



## Fatkeqësia Natyrore e Nëntorit 2019

Më 26 Nëntor, qyteti i Durrësit dhe ai i Tiranës u tronditën nga një prej tërmeteve më të fuqishëm që kanë goditur ndonjëherë Shqipërinë. Në vazhde të kësaj tragjedie, solidarizimi ka qënë absolut dhe i menjëhershëm. Shqiptarët e Ballkanit treguan një koordinim dhe solidarizim impresionues, në veçanti shqiptarët e Kosovës që ishin të parët që iu përgjigjën thirrjes për ndihmë urgjente. Krahas ndihmave në fonde, ushqime dhe veshmbathje, vullnetarë dhe ekipe shpëtimi apo ekspertë u dërguan në terren nga vende si: **Italia, Greqia, Rumania, Serbia, Zvicra, Franca dhe Izraeli.**

Forcat e ushtrisë shqiptare, forcat speciale, zjarrfikëset si dhe emergjencat civile punuan sëbashku në përpjekje maksimale për të gjetur jetë nën rrënoja. Rrjetet sociale, portalet dhe platformat e ndryshme kanë luajtur një rol të rëndësishëm në adresimin e ndihmës ndaj grupeve në nevojë të prekura nga tërmeti. Platforma kryesore dhe gjithëpërfshirëse është portali qeveritar, e-Albania. Fushatat më të shumta janë realizuar përmes Facebook dhe platformave crowdfunding si GoFundMe, JustGiving, Go Get Funding, Giving Balkans, Fundly, etj.

Mbi 89% e fushatave të dhurimit qënë nismë e Diasporës Shqiptare, ndonëse dhurimet erdhën nga çdo cep i globit. Ndër fushatat e shumta të dhurimit, spikasin edhe ato të ngritura nga familjarë të personave që humbën të dashurit e tyre. Shumë prej organizatorëve të këtyre fushatave u shprehën se do ti shpërndajnë vetë dhurimet tek të prekurin nga tërmeti, ndërsa një pjesë zgjedhën ti kanalizojnë përmes organizatave jofitimprurëse, ku mund të përmendim: Kryqin e Kuq, Caritas, Fundjavë Ndryshe, Fondacionin Firdeus, etj. Organizatat jofitimprurëse u angazhuan duke grumbulluar ushqime, veshje, batanije, dyshekë, materiale higjienike dhe duke ofruar ndihma mjekësore. Gjithashtu si pjesë e një ndërhyrjeje më të koordinuar në bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe ato donatore, OJF-të ofruan shërbime të mbështetjes psikologjike dhe organizuan aktivitetet rekreative për fëmijët, gratë dhe moshën e tretë pranë qendrave të akomodimit.


Në ditët që pasuan 26 nëntorin, pati një aktivizim të të gjitha strukturave shtetërore por jo vetëm. Krahas punës së admirueshme të bluzave të bardha dhe forcave të kërkim-shpëtimit, të gjithë dhanë kontributin e tyre sipas fushës së mbulimit.

Një tragjedi e kësaj përmase ka qënë pa dyshim një sprovë e fortë për Shqipërinë por pavarësisht të gjithave empatia, solidariteti dhe mbështetja nuk kanë munguar. Kjo na bën të shpresojmë në një rimëkëmbje të plotë dhe në një shërim të ngadaltë por të sigurt të plagëve që shkaktoi kjo fatkeqësi natyrore.



# **Krahasimi ndërmjet 2018 - 2019**

## Numri i dhurimeve



Vihet re se gjatë vitit 2019 numri i dhurimeve dhe ndjenja e solidaritetit ndaj çështjeve të ndjeshme sociale shënuan rritje të dukshme.

Në vitin 2019 vlera e përgjithshme e dhurimeve arriti shumën prej 1,556,350,829 lekë që është **1,535% më shumë se në vitin 2018**.


E njëjta gjë mund të thuhet në lidhje me numrin e dhurimeve. Në vitin **2018**, janë regjistruar **328 dhurime** ndërsa në vitin **2019**, **499 dhurime** që është **34% më shumë sesa në 2018**.

Kjo është si për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit ashtu edhe tërmetit katastrofik të nëntorit që rezultoi në një mobilizim të pazakontë dhe solidariteti të menjëhershëm.

## Vlera e dhurimeve



## Tre dhuruesit kryesorë




Gjatë vitit 2019, u vu re një përfshirje dhe koordinim në rritje ndërmjet dhuruesve.

Nuk është rastësi që lloji kryesor i dhuruesve për vitin 2019 ishin në të vërtetë dhuruesit Miiks, ndjekur nga Korporata dhe Publik i Gjerë.

Sa i përket fushave të dhurimit, Mbështetja e Grupeve të Margjinalizuar mbetet fusha kryesore siç ishte në vitin 2018. Zbutja e varfërisë është sërish ndër tre fushat kryesore të dhurimit ashtu siç ishte edhe në vitin 2018.

Sidoqoftë në vitin 2019 kemi Fatkeqësinë Natyrore si fushën e dytë të dhurimit në krahasim me Dhurimin sezonal në vitin 2018. Kjo natyrisht për shkak të fatkeqësisë natyrore të nëntorit dhe pasojave të saj.





Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,  
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1  
1010 Tirana, Albania